



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës që ju drejtoni, në përgjigje të kërkesës për informacion regjistruar me numër rendor 18, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin Nr. 3566 Prot., datë 20.06.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 146 të Kodit Zgjedhor miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11700, datë 06.09.2020 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, zhvilloi mbledhjen plenare të radhës dhe me anë të vendimit nr. 275 datë 08.09.2020 miratoi listën e gjyqtarëve të cilët u përfshin në shortin për përzgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

<https://klgj.al/2020/09/njoftim-per-shtyp-8-shtator-2020/>

Në vijim, Këshilli organizoi hedhjen publike të shortit për përzgjedhjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të vendimit nr. 293 datë 09.09.2020, miratoi zgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor si më poshtë:

1. Znj. Manjola Xhaxho
2. Z. Gentian Medja
3. Z. Sokol Ibi
4. Znj. Alma Kolgjoka
5. Znj. Emona Muçi
6. Znj. Esmeralda Çeka (Xhili)
7. Z. Asim Vokshi
8. Znj. Edlira Petri

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të shkresës regjistruar pranë KLGJ-së me aktin nr. 416 prot., datë 21.01.2022, është vënë në dijeni nga Institucioni i Presidentit të Republikës mbi caktimin e datës 6 mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore.

Me dekretin nr. 13188, datë 29.07.2021 të Presidentit të Republikës, z. Asim Vokshi është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe në vijim të marrjes së

masave sipas kompetencave dhe detyrimeve ligjore përkatëse, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në ligjin nr. 115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 146 dhe 148 të Kodit Zgjedhor miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 31 datë 20.01.2022 ka vendosur të miratojë listën e gjyqtarëve të cilët do të përfshihen në shortin për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të internetit të KLGJ-së si dhe në rubrikën Njoftime për shtyp gjeni të publikuar listën e gjyqtarëve:

<https://klgj.al/2022/01/njoftim-per-shtyp-date-20-janar-2022-2/>

Në respektim të afateve ligjore, Këshilli, në datën 21.01.2022, organizoi hedhjen publike të shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Shorti përzgjodhi gjyqtaren e Gjykatës Administrative të Apelit, znj. Blerona Hasa, si anëtare të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Pas procedurës së shortit, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhje plenare dhe vendosi miratimin e zgjedhjes së znj. Blerona Hasa, për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, me anë të vendimit nr. 32, datë 21.01.2022.

Në vijim në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua ceremonia e betimit të anëtares së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. Blerona Hasa.

Me Dekretin me nr. 13497, datë 07.03.2022 të Presidentit të Republikës, z. Gentian Medja është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, duke u krijuar 1 vakancë në përbërjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Për sa më sipër, Këshilli, me vendimin nr. 85, datë 08.03.2022, miratoi listën e gjyqtarëve të cilët u përfshin në shortin për plotësimin e vendit vakant të sipërcituar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Këshilli, me vendimin nr. 89, datë 09.03.2022, vendosi miratimin si anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor të anëtares, znj. Marsela Dervishi.

Gjithashtu ju informojmë se, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 99, datë 18.03.2021 ka caktuar vendin e zhvillimit të seancave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pranë sallës “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë.

Bashkëlidhur lutemi gjeni vendimet mbi miratimin e anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, procesverbalet e mbledhjeve plenare për pikat që janë diskutuar mbi çështjet që lidhen me Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor si dhe vendimin e Këshillit për caktimin e vendit të zhvillimit të seancave gjyqësore të KZGJ-së. (gjithsej 54 fletë)

Ju faleminderit për mirëkuptimin!